



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

PROVIM I MATURËS SHTETËRORE 2025

ME ZGJEDHJE – SESIONI I

Skemë vlerësimi

Lënda: Qytetari dhe Psikologji
Varianti A

24 qershor 2025

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	B	C	D	C	B	A	D	B	C	B
Pyetja	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26
Alternativa e saktë	A	A	D	C	B	B	C	B	C	D

Vlerësimi është 1 pikë për çdo përgjigje të saktë

Pyetjet me zhvillim

Shënim: Për pyetjet me zhvillim, nxënësi fiton pikë, edhe nëse jep përgjigje të tjera që nuk janë parashikuar në skemë, por që komisioni i quan të sakta.

Qytetari

Pyetja 11

Model përgjigjeje

- - Formimin e shprehive;
 - Zhvillimin e mendimit kritik;
 - Zhvillimin e talenteve;
 - Përvetësimin e njohurive teorike dhe shprehive praktike;
 - Pranimin e ndryshimeve;
 - Toleranca;
 - Etj.
- - stimulimi për të menduar në mënyrë krijuese lidhur me temën, duke bërë një punë kërkimore paraprakisht.
 - stimulimi për të menduarit kritik lidhur me temën e cila mund të pozicionojë nxënësit pro ose kundër në varësi të argumenteve që japin.
 - zhvillimi i një konkurrence të shëndetshme përmes realizimit të konkursit midis nxënësve. Inkurajimi i fitores së më të mirit.

- përvetësimi i shprehive të një shoqërie demokratike si mosbindja ndaj autoritetit bazuar në argumente të arsyeshëm. Përdorimi i mjeteve të ligjshëm për një sistem demokratik të konsoliduar.
- krijimi i një mjedisi që stimulon zhvillimin e ideve novatore dhe argumentet për çështjet e qytetarisë aktive në mënyrë që t'ju përgjigjen sfidave të së ardhmes.
- Etj.

Nxënësi fiton:

- 4 pikë** nëse përcakton funksionin që realizon shkolla dhe shpjegon tre aspekte të rëndësishme të aktiviteteve të tilla për nxënësit;
- 3 pikë** nëse se përcakton funksionin që realizon shkolla dhe shpjegon dy aspekte të rëndësishme të aktiviteteve të tilla për nxënësit; nëse shpjegon tre aspekte të rëndësishme të aktiviteteve të tilla për nxënësit;
- 2 pikë** nëse përcakton funksionin që realizon shkolla dhe shpjegon një aspekt të rëndësishme të aktiviteteve të tilla për nxënësit; nëse shpjegon dy aspekte të rëndësishme të aktiviteteve të tilla për nxënësit;
- 1 pikë** nëse përcakton funksionin që realizon shkolla; nëse dhe shpjegon një aspekt të rëndësishme të aktiviteteve të tilla për nxënësit;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 12

Model përgjigjeje

- Përhapja e lajmeve të rreme të cilat dezinformojnë qytetarët. Mediat të cilat publikojnë lajme pa verifikuar faktet, mund të propagandojnë informacione të pavërteta të cilat krijojnë konfuzion dhe cenojnë besimin e qytetarëve. Kjo dëmton vendimmarrjen e informuar të qytetarëve.
 - Liria e pakushtëzuar e medias mund të prodhojë lajme të pavërteta të cilat cenojnë të drejtën e të dhënave konfidenciale, të jetës private, cenojnë dinjitetin, e personit ndaj të cilit publikohen këto lajme.
 - Liria e pakushtëzuar e medias mund të nxis diskriminimin, gjuhën e urrejtjes mbi baza etnike, racore, gjinore etj.
 - Publikimi i lajmeve të tilla pa asnjë kufizim cenon mirëqenien dhe sigurinë publike. Përhapja e përmbajtjeve të paligjshme, të rrezikshme, etj., pa asnjë kufizim duke u shpërndarë gjerësisht mund të nxis dhunë, terrorizëm etj.
 - Përhapja e lajmeve të rreme në aspektin politik ndikon në manipulimin e opinionit publik. Publikimi i lajmeve të rreme ndikon në proceset demokratike dhe zgjedhje duke përmbushur objektiva të caktuara politike, ekonomike etj.
 - Etj.
- 3 pikë** nëse analizon tre probleme që shkakton liria e pakushtëzuar në median online;
- 2 pikë** nëse analizon dy probleme që shkakton liria e pakushtëzuar në median online;
- 1 pikë** nëse analizon një problem që shkakton liria e pakushtëzuar në median online;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 13

Model përgjigjeje

- Të drejtat për mjedisin dhe zhvillimin; të drejta për mjedisin; brezi/kategoria i tretë i të drejtave.
 - Të drejta sociale dhe ekonomike; brezi/kategoria dytë.
 - Të drejta civile dhe politike; brezi/kategoria parë.
- 3 pikë** nëse dallon tre kategori (brez) të të drejtave. probleme që shkakton liria e pakushtëzuar në median online;
- 2 pikë** nëse analizon dy probleme që shkakton liria e pakushtëzuar në median online;
- 1 pikë** nëse analizon një problem që shkakton liria e pakushtëzuar në median online;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 14**Model përgjigjeje**

- Kushte pune të përshtatshme. Punëdhënësi të sigurojnë një mjedis pune që është i sigurt dhe i shëndetshëm;
- Shpërblimi në rast aksidenti në punë;
- E drejta e lejes vjetore dhe ditët e festave;
- E drejta e pagës dhe pagesës për orët shtesë;
- Mbrojtje nga diskriminimi;
- E drejta e respektimit të orarit (me përjashtim të rasteve urgjente);
- Etj.

4 pikë nëse përshkruan katër nga të drejtat që i takojnë punëmarrësit;

3 pikë nëse përshkruan tre nga të drejtat që i takojnë punëmarrësit;

2 pikë nëse përshkruan një nga të drejtat që i takojnë punëmarrësit;

1 pikë nëse analizon një problem që shkakton liria e pakushtëzuar në median online.

0 pikë nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 15**Model përgjigjeje**

- Kërkesat
 - Leje pune/Vizë: Një nga kërkesat kryesore është marrja e një leje pune ose vize për të punuar ligjërisht në vendin evropian të zgjedhur;
Çdo vend evropian ka rregullat dhe rregulloret e veta specifike që rregullojnë lejet e punës dhe vizat për punëtorët e huaj;
Të rinjtë shqiptarë do të duhet të kalojnë procesin e aplikimit, i cili zakonisht përfshin sigurimin e dokumentacionit të nevojshëm, vërtetimin e punësimit ose ofertën e punës dhe përmbushjen e kriterëve specifike të përshtatshmërisë të përcaktuara nga vendi i destinacionit.
 - Njohja e gjuhës: Aftësia në gjuhën e folur në vendin e destinacionit është shpesh një kërkesë thelbësore për punësim;
Punëdhënësit evropianë në përgjithësi presin që kandidatët të zotërojnë mirë gjuhën vendase për të komunikuar në mënyrë efektive me kolegët, klientët dhe klientët;
Të rinjtë shqiptarë që aspirojnë të punojnë në Evropë mund të kenë nevojë të demonstrojnë aftësitë e tyre gjuhësore përmes testeve ose intervistave të standardizuara gjuhësore.
 - Kualifikimet/aftësitë arsimore: Punëdhënësit evropianë shpesh vlerësojnë kualifikimet arsimore dhe aftësitë specifike kur marrin në konsideratë punëkërkuarit e rinj shqiptarë;
Në varësi të industrisë ose profesionit, punëdhënësit mund të kërkojnë një nivel të caktuar arsimimi, si diplomë bachelor ose master, ose trajnime dhe certifikime specifike profesionale;
Aplikantëve për punë mund t'u duhet gjithashtu të shfaqin përvojën përkatëse të punës ose të demonstrojnë aftësi që kërkohen në tregun evropian të punës, ekspertiza teknike ose njohuri të specializuara në fusha specifike.
- Etj.

Përparësi:

- Emigrimi mund të ndikojë në përmirësimin e kushteve të punës dhe mundësitë e rritjes profesionale.
- Emigrimi mund të sjellë mundësi më të mira në aspektin financiar duke përmirësuar standardet e jetesës.
- Etj.

3 pikë nëse analizon dy nga kërkesat me të cilat përballen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë dhe shpjegon një përparësi të emigrimit për qëllime punësimi;

- 2 pikë** nëse analizon dy nga kërkesat me të cilat përballen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë; nëse analizon një nga kërkesat me të cilat përballen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë dhe shpjegon një përparësi të emigrimit për qëllime punësimi;
- 1 pikë** nëse analizon një nga kërkesat me të cilat përballen emigrantët shqiptarë në botën e punës jashtë Shqipërisë; nëse shpjegon një përparësi të emigrimit për qëllime punësimi;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 16

Model përgjigjeje

- Të informohet paraprakisht, në mënyrë që të bëjë një blerje të kujdesshme. Moda e shpejtë, inkurajon konsumin përtej nevojave dhe brenda një buxheti të përbalueshëm, ndaj konsumatorët nuk i kushtojnë vëmendje cilësisë së produkteve që ofrohen.
- Të mbajë përgjegjësi shoqërore, që do të thotë të vlerësojë se si ndikojnë veprimet e tij në një grup të disavantazuar të shoqërisë dhe cilat janë efektet e veprimeve të tij në aspektin shoqëror, ekonomik.
- Të vlerësojë pasojat ekologjike;
- Të tregojë solidaritet, duke mbështetur dhe mbrojtur të drejtat e punonjësve të fasonerisë.
- Të ruajë faturën.
- Etj.

- 3 pikë** nëse përshkruan tri përgjegjësi të konsumatorit;
- 2 pikë** nëse përshkruan dy përgjegjësi të konsumatorit;
- 1 pikë** nëse përshkruan një përgjegjësi të konsumatorit;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Psikologji

Pyetja 27

Model përgjigjeje

- -Stadi operacional formal
 - -“nxënësit arritën të bënin një analogji”, “nxënësit parashtruan shumë pyetje”, tregon se ata janë të aftë të përdorin logjikën, diskutojnë në mënyrë racionale, kanë aftësi të kuptojnë analogjinë dhe trajtojnë çështje me natyrë abstrakte.
 - Nxënësit kanë aftësi të reflektojnë, të nxjerrin përfundime.
 - Nxënësit kanë aftësi të diskutojnë për çështje abstrakte. Nxënësit kanë aftësi të parashtrojnë pyetje. Ata arrijnë të bëjnë analogji midis mesazhit të librit dhe vendosmërisë për t'u përballur me vështirësi të ndryshme në jetë, pa u dorëzuar.
 - -Në këtë fazë zhvillimi individ i krijon identitetin e tij në ndërveprim me të tjerët, formon aftësitë krijuese dhe kritike për të reaguar dhe marrë vendime të ndryshme të jetës, për të zgjidhur probleme etj.
 - Në këtë fazë zhvillimi krijohet morali autonom, bazuar në parime personale (morali paskonvencional).
- Etj.

- 4 pikë** nëse përcakton stadin e zhvillimit, shpjegon dy aspekte të këtij stadi;
- 3 pikë** nëse përshkruan tri përgjegjësi të konsumatorit;
- 2 pikë** nëse përshkruan dy përgjegjësi të konsumatorit;
- 1 pikë** nëse përshkruan një përgjegjësi të konsumatorit;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Pyetja 28

Model përgjigjeje

- Drejtimi humanist
- Drejtimi bihejviorist
- Drejtimi kognitivist

- 3 pikë** nëse përcakton saktë tre drejtimet psikologjike;
2 pikë nëse përcakton saktë dy drejtimet psikologjike;
1 pikë nëse përcakton saktë një drejtim psikologjik;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 29**Model përgjigjeje**

- -Sistemi nervor autonom, simpatik;
- -Sistemi nervor qendror, formacioni retikular;
- -Sistemi nervor simpatik mobilizon automatikisht trupin për t'ju përgjigjur situatave të vështira. Sistemi nervor simpatik stimulon zemrën të rrahë më shpejt, duke pompuar më shumë gjak, mushkëritë punojnë më shpejt duke siguruar më shumë oksigjen.
- -Sistemi nervor simpatik rrit vigjilencën dhe fokusin.
- -Formacioni retikular është përgjegjës për vigjilencën.
- -Sekretimi i adrenalinës dhe noradrenalinës ndikon në rritjen e rrahjeve të zemrës dhe në shpeshitim të frymëmarrjes. Ky sekretim ndikon që tek Gentjani të çlirohet më shumë energji për të përballuar situatën në të cilën ndodhet.

- 3 pikë** nëse përcakton saktë sistemin nervor dhe përshkruan dy funksionet e tij;
2 pikë nëse përcakton saktë sistemin nervor dhe përshkruan një nga funksionet e tij;
1 pikë nëse përcakton saktë sistemin nervor; nëse përshkruan një nga funksionet e tij e sistemit nervor;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 30**Model përgjigjeje**

- Ndryshimet jetësore të çiftit që janë në pritje të fëmijës. Ata përballen me mungesën e të ardhurave nga papunësia, tashmë që janë zhvendosur për të jetuar në një qytet të ri.
- Konflikti që Besa ka mes dy kërkesave, për të zgjedhur midis eksperiencës së punës dhe realizimit të studimeve për kualifikimin profesional.

- 2 pikë** nëse shpjegon burimin e stresit për dy situatat;
1 pikë nëse shpjegon burimin e stresit për një situatë;
0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 31**Model përgjigjeje**

- Përfshirja dhe pranimi i diversitetit. Njohja me kultura të ndryshme ndihmon të sfidohen paragjykimet. Mjediset gjithëpërfshirëse ndihmojnë për të ndërtuar marrëdhënie mbi bazën e respektit.
- Dëgjimi aktiv dhe të qenit i hapur, pranues ndaj të ndryshmit, inkurajon njohjen dhe respekt për dinjitetin njerëzor.
- Ndikimi i familjes në shoqërizimin e fëmijëve me vlerat dhe parimet që mbështesin barazinë, tolerancën, gjithëpërfshirjen etj.
- Roli i shkollës në promovimin e vlerës së tolerancës përmes aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin dhe barazinë.
- Ndikimi i medias dhe aktorëve të tjerë socializues në transmetimin e vlerave të barazisë, empatisë, pranimit të tjetrit ndryshe, etj.
- Etj.

- 3 pikë** nëse analizon tri mënyra që ndihmojnë në përmirësimin e marrëdhënieve midis njëri-tjetrit duke demonstruar qëndrime tolerance;

- 2 pikë** nëse analizon dy mënyra që ndihmojnë në përmirësimin e marrëdhënieve midis njëri-tjetrit duke demonstruar qëndrime tolerance;
- 1 pikë** nëse analizon një mënyrë që ndihmonë në përmirësimin e marrëdhënieve midis njëri-tjetrit duke demonstruar qëndrime tolerance;
- 0 pikë** nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.
-

Pyetja 32

Model përgjigjeje

- Ndihma profesionale në përmirësimin e shëndetit mendor ndikon në trajtimin e çrregullimeve psikologjike të të ngrënit. Edukimi mbi temat që ndërlidhin tre komponentët e shëndetit ndihmon adoleshentët në përmirësimin e vetëvlerësimit, menaxhimit e stresit, ushqyerjen e shëndetshme, etj. Kujdesi për shëndetin mendor ndihmon edhe në parandalimin e problemeve shëndetësore afatgjatë.
- Komponentët e shëndetit si ai fizik, social dhe psikologjik janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin dhe ndikojnë në mirëqenien e përgjithshme. Adresimi i duhur i nevojave të shëndetit mendor përmes moduleve të kujdesit psikologjik ndihmon adoleshentët të përballojnë sfidat dhe të prirën drejt zakoneve që promovojnë një jetesë të shëndetshme. Çrregullimet e të ngrënit kanë pasoja në shëndetin fizik.
- Trajtimi i çështjeve psikologjike përmes një edukimi gjithëpërfshirës të mirëqenies është i nevojshëm për të shmangur rreziqet shëndetësore që vijnë nga anoreksia dhe bulimia, si dhe për t'i fuqizuar e ndihmuar adoleshentët të krijojnë praktika të përshtatshme për të menaxhuar sfidat dhe për t'i kaluar me sukses.
- Etj.

2 pikë nëse jep dy argumente për nevojën e përmirësimit të shëndeti mendor;

1 pikë nëse jep një argument për nevojën e përmirësimit të shëndeti mendor;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.

Pyetja 33

Model përgjigjeje

- Kujtesën semantike.
- Kujtesën episodike.
- Kujtesën procedurale ose e shprehive.

3 pikë nëse përcakton saktë llojin e kujtesës për tri situatat;

2 pikë nëse përcakton saktë llojin e kujtesës për dy situatat;

1 pikë nëse përcakton saktë llojin e kujtesës për një situatë;

0 pikë nëse përgjigjet gabim OSE nuk përgjigjet fare.
